

ASPEKTE ZHVILLIMORE TË ARSIMIT TË LARTË

UP gjatë këtij viti do të vazhdojë bashkëpunimin me shumë institucione ndërkombëtare, të cilat që nga paslufta e kanë ndihmuar arsimin kosovar, në përgjithësi, si programi Tempus, VUS Austria, projekti i Erasmus Mundus, e shumë projekte tjera

Projektet e UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS



Projektet e UP-së për vitin 2011 janë vazhdimësi e projekteve të vitit 2010. Një ndër to është edhe hartimi i planeve dhe programeve mësimore sipas sistemit të Bolonjës. Shumica e njësisve akademike i kanë dhënë propozimet, i kanë formuar komisionet që do t'i shqyrtojnë dhe krahasojnë programet me ato që janë marrë deri më 15 shkurt dhe të njëjtat do jenë të gatshme t'i shkojnë AAK-së për akreditim. Në këto programe do të futet edhe gjuha shqipe si lënë e obligueshme, ku studentët do ta mësojnë gjuhën e shkruar dhe standarde shqipe. Një projekt tjetër i UP-së është edhe bashkëpunimi i Universitetit me universitetet e rajonit, veçmas me atë të Lubjanës, Zagrebit dhe Shkupit, duke mos i përjashtuar dhe universitetet evropiane. Në bazë të një marrëveshjeje që UP-ja ka me Universitetin e Lubjanës për studime të doktoratës, do të dërgohen për 4 muaj kandidatët e UP-së dhe për tre vjet studime të doktoraturës, studentët do të qëndrojnë me shpenzime të këtij universiteti.

Përveç kësaj, do bashkëpunohet edhe me shumë universitete tjera. Përveç kësaj, UP-ja gjatë këtij viti do ta vazhdojë bashkëpunimin me shumë institucione ndërkombëtare, të cilat që nga paslufta e kanë ndihmuar arsimin kosovar në përgjithësi, si programi Tempus, VUS Austria, projekti i Erasmus Mundus e shumë projekte tjera.

Projektet që nisin të zbatohen sivjet
Në anën tjetër, menaxheri i VUS Austria në Prishtinë, But Deda, ka theksuar se në funksion të mbështetjes së arsimit të lartë në Kosovë, të krahasueshëm dhe konkurrent në hapësirën evropiane të arsimit të lartë, gjatë vitit 2010 VUS Austria ka vazhduar me zbatimin e një sërë projektesh në fusha të ndryshme, duke përfshirë projekte për sigurim të cilësisë, reformim dhe zhvillim të programeve mësimore, kurrikulave, ngritjen e kapaciteteve profesionale etj.

Projektet që nisin të zbatohen sivjet

Ndërkaq, në fillim të vitit 2011 është bërë nisja e dy projekteve të reja serioze dhe shumë të rëndësishme, të financuara nga Komisioni Evropian nëpërmjet programit TEMPUS, nga të cilat do të përfitojë Universiteti i Prishtinës. "Njëri nga projektet titullohet "Kompetenca në Universitetin e Prishtinës" dhe ka për qëllim themelimin e qendrave të kompetencës në UP, të cilat do të shërbejnë edhe si qendra që ofrojnë shërbime për studentë dhe stafin akademik dhe do të kontribuojnë në sigurim-

in e cilësisë dhe në avancimin e partneritetit me ndërmarrjet private. Nëpërmjet këtij projekti, do të zhvillohet katalogu i kompetencës dhe i sistemit të informacionit, i cili do të kontribuojë që ta bëjë arsimin në UP më transparent dhe më të kapshëm. Në këtë mënyrë, projekti do ta lidhë arsimin me tregun e punës dhe do ta mbështesë mësimin me qasje gjatë gjithë jetës", ka sqaruar Deda.

Shkenca e teknologjisë së ushqimit
Kurse, projekti i dytë, i cili ka filluar sivjet, është "PhD në 'Shkencat e Ushqimit dhe Teknologji të Ushqimit' dhe në krijimin e kapaciteteve për reformë në PhD në Universitetin e Prishtinës. Ky projekt ka për qëllim inicimin dhe zhvillimin e një programi inter-disiplinar të doktoratës në UP në drejtimin e "Shkencave të Ushqimit dhe Teknologjinë e Ushqimit". Fillimi i këtij programi të PhD do të kontribuojë në arsimimin dhe përgatitjen e ekspertëve të rinj në fushën e teknologjisë së ushqimit. Përveç kësaj, ideja është që të krijohet një praktikë model në UP, ku ofrohen programe të doktoratës, të cilat bazohen në standardet më të larta evropiane në kurrikula bashkëkohore dhe në trend me zhvillimet e fundit në shkencë, hulumtime shkencore me metoda bashkëkohore, mobilitet të studentëve, ndërkombëtarizim dhe sigurim të cilësisë.

Shkenca e teknologjisë së ushqimit

V. REXHA

Modeli evropian

Ideja është që të krijohet një praktikë model në UP, ku ofrohen programe të doktoratës, të cilat bazohen në standardet më të larta evropiane.